



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 3337 / Prot.  
A

Tiranë, më 16.9.2021

**NJOFTIM PËR VENDE PUNE**

**A. Konkurs për Pranim në Kategorinë e Nëpunësve Civilë të Lartë Drejtues**

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu VI – "Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues", neni 20, 21 dhe 32 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, datë 05.03.2014, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë dhe anëtarëve të TND-së", i ndryshuar, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se;

a) Në Administratën e tij ka 2 (dy) vende të lira pune të nivelit të lartë drejtues, në pozicionin, Inspektor.

**Paga e pozicionit- II-a**

Në përputhje me Vendimin nr.48, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.55/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave", të ndryshuar".

Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues, në pozicionin, Inspektor, do të bëhet me konkurrim dhe është i hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil.

b) Pëshkrimi i detajuar i vendit të punës;

**B.1) PËR 1 (NJË) VEND INSPEKTOR**

Inspektori në ILDKPKI, merret me mbledhjen e të dhënave, kryerjen e hetimeve dhe kërkimeve administrative rreth deklarimeve të subjekteve që kanë detyrim ligjor për deklarim dhe personave të lidhur me ta, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar; Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, Ligjin nr. 60/2016,

datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, akteve nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm dhe Kodit të Procedurave Administrative. Është përgjegjës për kryerjen e detyrave të ngarkuara gjatë kontrollit aritmetik e logjik, kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ ndaj deklarimeve të interesave private të subjekteve dhe personave të lidhur me ta, për parandalimin dhe goditjen e korrupsionit dhe zyrtarëve të korruptuar në sektorin publik e privat si dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë veprimet korruptive në institucionet publike dhe private.

Propozon masa konkrete për t'u ndërmarrë në përfundim të kontrolleve të plota dhe hetimit administrativ, në varësi të rezultateve të arritura. Veprimtaria e Inspektorit bazohet në ligjet dhe aktet nënligjore të ILDKPKI, si dhe në Urdhrat e Inspektorit të Përgjithshëm.

## **B.2) PËR 1 (NJË) VEND INSPEKTOR**

Inspektori në ILDKPKI, merret me mbledhjen e të dhënave, kryerjen e hetimeve dhe kërkimeve administrative rreth deklarimeve të subjekteve që kanë detyrim ligjor për deklaram dhe personave të lidhur me ta, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar; Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, Ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", i ndryshuar, akteve nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm dhe Kodit të Procedurave Administrative. Është përgjegjës për sigurimin e informacionit nga media, shoqëria civile, publiku e të tjerë për rastet e fshehjes së pasurisë, rasteve të konfliktit të interesit për zyrtarët që ushtrojnë funksionet publike, si dhe praktikave të dyshuara të korrupsionit në sektorin publik dhe privat. Përgatitja e materialeve informuese dhe hetimore për Inspektorin e Përgjithshëm. Veprimtaria e Inspektorit bazohet në ligjet dhe aktet nënligjore të ILDKPKI, si dhe në Urdhrat e Inspektorit të Përgjithshëm.

### **c) Kërkesat e Përgjithshme**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar;

- Të jetë shtetas shqiptar,
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur,
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse,
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje,
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

### **ç) Kërkesat specifike që duhet të plotësojë kandidati për kategorinë B.1**

- Të jetë nëpunës civil në kategorinë e mesme drejtuese të shërbimit civil;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë dy vlerësimet e fundit "Shumë mirë".

- Të ketë një ekperiencë pune mbi 5 vjet në profesion dhe të ketë përvojë pune në fushat: juridike, financiare, bankare, të kontrollit dhe hetimit administrativ, investigative dhe ato analitike,
- Niveli i diplomës duhet të jetë “*Master i Shkencave*”, në shkencat Juridike ose Ekonomike apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi,
- Të ketë njohuri të mira në një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze,
- Të njohë dhe të përdorë shumë mirë programet bazë të kompjuterit,
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike,
- Të ketë njohuri të gjera dhe aftësi në lidhje me fusha që trajtojnë çështjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave si dhe të administratës publike në tërësi, auditimit, ekspertizës financiare, apo ekspertizës së vlerësimit të pasurive, etj.
- Aftësi të drejtimit të punës në grup, komunikimi, hartimit të dokumentave të ndryshëm dhe të respektimit të afateve,
- Kandidatët duhet të kenë aftësi shumë të mira gjyqimi, analitike, hetimi dhe iniciativë për të marrë vendime komplekse.

**d) Kërkesat specifike që duhet të plotësojë kandidati për kategorinë B.2**

- Arsim të lartë me diplomë “*Master i Shkencave*” apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë,
- Të ketë një ekperiencë pune mbi 10 vjet në fushën e gazetarisë,
- Të jetë individ me personalitet dhe integritet, me aftësi shumë të mira gjyqimi, analitike, hetimi dhe iniciativë për të marrë vendime komplekse,
- Të ketë njohuri në një gjuhë të huaj,
- Të ketë njohuri të programeve bazë kompjuterike,
- Trajnime në lidhje me fusha që trajtojnë çështjen e korrupsionit,
- Aftësi të drejtimit të punës në grup, dhe hartimit të dokumentave të ndryshëm.

**e) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant
2. Një kopje të jetëshkrimit (C.V.)
3. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin
4. Fotokopje e listës së notave
5. Një fotokopje e librezës së punës e plotësuar
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore dhe shëndetësore
7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim
8. Fotokopje e kartës së identitetit
9. Konfirmimin si nëpunës civil në kategorinë e mesme drejtuese të shërbimit civil

10. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni)

11. Të ketë dy vlerësimet e fundit "Shumë mirë".

Mosparaqitje e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

**Kandidatët duhet të dorëzojnë, të gjitha dokumentat e cituara më sipër brenda datës 18.10.2021.**

#### **dh) Mënyra e shqyrtimit dhe shpallja e rezultateve të seleksionimit paraprak**

Konkurimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Konkurimi do të zhvillohet në dy faza:

- Verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë
- Vlerësimi i kandidatëve në testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë

#### **e) Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Në datën **25.10.2021** do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, e cila do të shpallet në portalin "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në standën e informimit të publikut. Këta do të jenë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë njësisë përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

#### **ë) Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurimi**

Konkurimi - intervista me gojë do të bazohet në njohuritë për specialitetin,

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar
- Ligjin nr.9367, datë 07.4.2005, "*Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", i ndryshuar
- Ligji nr. 60, datë 2.6.2016, "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", i ndryshuar
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi i Procedurave Civile
- Kodi i Procedurave Penale
- Ligji nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*"
- Legjislacioni në fuqi për sistemin e taksave dhe procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar

- Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

#### **f) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen;

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit, përvoja dhe trajnimet.
- b) Vlerësimi me shkrim,
- c) Intervista e strukturuar me gojë.

Kandidatët do të vlerësohen nga "Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP)", i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 10 pikë për vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore në dokumentacionin e dorëzuar;
- 40 pikë për testim me shkrim;
- 50 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

**g) Konkurrimi-testimi me shkrim do të bëhet, në mjediset e ILDKPKI në datën 17.11.2021, ora 10:00**

#### **gj)Mënyra e njoftimit dhe komunikimit**

**Lista e fituesve me mbi 70 pikë (70% të pikëve)**

Kandidatë fitues janë kandidatët që marrin mbi 70 pikë e lart.

Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë KPP brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

**Njoftimi do të bëhet në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në stendën e informimit të publikut.**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të ILDKPKI.

**ILDKPKI  
NJËSIA PËRGJEGJËSE**